



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 21 mars 2011
Nr. ref.: RK 103/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 40/10

Parashtruesi

NLB Prishtina sh. a.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Mle-Rev. nr. 19/2009, të 16 marsit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është NLB Prishtina sh. a., e përfaqësuar nga z. Albert Lumezi si kryetar i Bordit menaxhues.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi që kontestohet nga parashtruesi i kërkesës është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), MLe-Rev. nr. 19/2009, i 16 marsit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon për shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë lidhur me kërkesën e tij për shqiptimin e masës së përkohshme kundër ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë E. nr. 382/09, të 18 nëntorit 2009, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Parashtruesi i kërkesës pretendon se do të shkaktohen dëme të pariparueshme, pasi parashtruesi i kërkesës nuk do të ishte në gjendje t'i kthente paratë duke marrë parasysh që parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë kredie me një palë të tretë (në tekstin e mëtejme: debitori) dhe debitori ka përgjegjësi ta paguajë shumën prej 269.686,04 eurove.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 dhe 27 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 54, 55 dhe 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 2 qershor 2010.
7. Kërkesa iu komunikua Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë dhe Gjykatës Supreme më 24 gusht 2010.
8. Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj, e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues Ivan Čukalović më 22 shkurt 2011 dhe i bëri rekomandim Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë kredie me debitorin më 22 tetor 2001. Kredia i është paguar debitorit menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.
10. Pasi debitori dështoi ta respektonte kontratën për kredi, parashtruesi i kërkesës ushtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Lipjan më 30 shtator 2002. Po të njëjtën datë, Gjykata Komunale në Lipjan deklaroi se nuk ishte kompetente për këtë çështje. Gjykatë kompetente është Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë.
11. Më 18 dhjetor 2002, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe e urdhëroi debitorin t'ia paguante borxhin e vet parashtruesit të kërkesës. Aktgjykimi u bë plotfuqishëm më 14 dhjetor 2004.
12. Më 13 janar 2004, debitori ushtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Lipjan për pasurim të paligjshëm nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Komunale në Lipjan deklaroi

se nuk ishte kompetente për këtë çështje, por tregoi që gjykatë kompetente ishte Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë.

13. Më 23 dhjetor 2004, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë e miratoi kërkesëpadinë e debitorit dhe i urdhëroi parashtruesit të kërkesës t'ia kompensonte debitorit pasurimin e paligjshëm. Më pas, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme.
14. Më 30 nëntor 2005, Gjykata Supreme miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe ia ktheu lëndën për rigjykim Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.
15. Më 14 qershor 2007, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë vendosi që kërkesëpadia e debitorit ishte e pabazuar dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës t'ia paguante debitorit pasurimin e paligjshëm. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme, e cila më 17 shtator 2009 vendosi që ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte e pabazuar dhe e miratoi aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.
16. Më 26 tetor 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë Publike kundër Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, të 14 qershorit 2007. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës gjithashtu ushtroi kërkesëpadi në Gjykatën Supreme më 5 nëntor 2009, me të cilën kërkonte revizionim të Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, të 14 qershorit 2007, si dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 17 shtatorit 2009.
17. Më 26 tetor 2009, debitori kërkoi nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë ta ekzekutonte aktgjykimin e vet. Më 28 tetor 2009, Gjykata lejoi ekzekutimin e aktgjykimit të vet. Më 17 tetor 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti kundërshtim kundër vendimit për ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, të 28 tetorit 2009. Më 19 nëntor 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë e refuzoi kundërshtimin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e miratoi vendimin për ekzekutim.
18. Më 1 dhjetor 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit për ekzekutim, e cila deri me tani nuk ka vendosur lidhur me çështjen në fjalë.
19. Më 18 dhjetor 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë nxori një aktgjykim me të cilin e urdhëronte parashtruesin e kërkesës që ta respektonte vendimin për ekzekutim. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë që ta shtynte vendimin për ekzekutim, pas të cilës ajo e shtyu ekzekutimin derisa të mos merrej vendim lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, që i ishte parashtruar Prokurorisë Publike (Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë E. nr. 382/2009, i 24 dhjetorit 2009). Nuk janë dorëzuar informata të mëtejshme.
20. Më 16 mars 2010, Gjykata Supreme vendosi që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës, e 26 tetorit 2009, për mbrojtje të ligjshmërisë ishte e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, duke thënë se kërkesëpadia e debitorit për pasurim të paligjshëm nuk ka bazë ligjore sepse ishte miratuar nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, më 23 dhjetor 2004, në kundërshtim me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 206/2002. Prandaj, aktgjykimi i formës së prerë është dashur të respektohej, përndryshe do të shkelej parimi kushtetues i të drejtave të garantuara ligjore të cilitdo subjekt, qoftë ai person fizik apo juridik.

22. Sipas mendimit të tij, çështja është se është shkelur marrëveshja për kredi për shkak se ajo ishte nënshkruar në bazë të vullnetit të lirë dhe të plotë të palëve kontraktuese pa ndonjë mangësi ligjore. Për këtë arsye, marrëveshja për kredi është dashur të respektohej.
23. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës ankohet që Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë kishte vendosur për ekzekutim përkundër faktit që Gjykata Supreme ende nuk kishte vendosur për ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Vendimit E. nr. 382/2009, të 19 nëntorit 2009.
24. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese t'i anulojë të gjitha vendimet e nxjerra në procedurat civile dhe ekzekutive, në mënyrë që Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, i 18 dhjetorit 2002 (që mori formën e prerë më 14 dhjetor 2004) të mbetet në fuqi.

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

25. Duke marrë parasysh parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjen që parashtruesi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë se ekziston një rast *prima facie*, siç përcaktohet me nenin 27 të Ligjit. Parashtruesi nuk ka paraqitur argumente bindëse që do të mund të pësonte dëm të pariparueshëm, po të mos miratohej kërkesa e tij për masa të përkohshme apo që ekziston interes publik për lejimin e masës së përkohshme.
26. Prandaj, Gjykata konkludon që kërkesa për masa të përkohshme nuk është e mbështetur me prova dhe për këtë arsye duhet të refuzohet.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, Gjykata thotë se për të qenë në gjendje për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
28. Parashtruesi i kërkesës mund të ankohet vetëm nëse gjykatat e rregullta kanë bërë lajthim të fakteve ose të ligjit, vetëm dhe nëse ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
29. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e shkallës së katërt kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin Nr. KI 13/09, Sevdail Avdyli, të 17 qershorit 2010, dhe *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës (GC), nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
30. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).
31. Në lidhje me këtë, vërehet se parashtruesi i kërkesës jo vetëm që nuk e ka ndërtuar rastin në ndonjë shkellje, por nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën tregon se aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishte i padrejtë ose i prekur nga arbitrariteti, kur e hodhi poshtë

kërkesën e parashtruesit si të pabazuar (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009, dhe Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

32. Prandaj, në përputhje me rregullin 36 (1. c) të Rregullores së punës, i cili thotë: "*Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar*", rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTË ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 22 shkurt 2011, njëzëri

VENDOS

- I. **TA HEDHË POSHTË** kërkesën si të papranueshme.

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Ivan Čukalović



Prof. Dr. Enver Hasani

